



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E BUJQËSISË PYJEVE DHE KULLOTAVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
Mariglen Disha

TERMAT E REFERENCËS

PËR OBJEKTIN

"Hartimin plani mbarështimi ekonomia pyjore Neshtë-Prevall

Neshtë-Prevall, Tetor 2025

1. TË PËRGJITHSHME

Plani i Mbarështimit (Menaxhimit) të Pyjeve dhe Kullotave (më poshtë PMPK) është një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve i hartuar sipas njësisë të ekonomisë pyjore me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e të dhënave për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura të nevojshme silvikulturore.

Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10-15 vjet duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike.

Në kuadër të reformës administrative-territoriale, Bashkisë Neshtë-Prevall nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.684 datë 02.09.2020 për disa ndryshime në Vkm, Nr.433, datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive", i kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në territorin e Bashkisë.

Duke patur parasysh se planet e Inventarizimit (Mbarështimit), janë hartuar në vitin 1985 dhe si rezultat afati kohor i tyre ka skaduar dhe duke patur parasysh se gjatë këtyre viteve në këto ekonomi pyjore kanë ndodhur ndryshime të mëdha, të cilat kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimeve të lëndës drusore, ndërhyrjeve të paligjshme, dëmtimet nga rënia e zjarreve, zënia e sipërfaqeve pyjore me anë të shpyllëzimeve (kthimi i tyre në vreshta, apo pemtari), ndryshimet në sipërfaqe dhe volum etj..., të cilat nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në regjistrat kadastral të fondit pyjor e kullor ndër vite (në zona të veçanta edhe nuk janë raportuar fare).

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Bashkia e Librazhd, Drejtoria e Bujqësisë së Pyjeve dhe Kullotave, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor, ka miratuar fond, i vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 2026, i miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Librazhd me objekt "**Hartimin plani mbarështimi për ekonominë pyjore** " për hartimin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Librazhd, për vitin 2026.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përlllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë planet e reja të mbarështimit të ekonomive pyjore.

Përlllogaritja e fondit limit e planifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit është realizuar mbështetur në VKM-në Nr.361, datë 12.05.2010, "Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik", e cila paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nr.	Pershkrimi i shërbimit	Njesia e matjes	Sasia	Cmimi/Tarifa/ lek/ ha	Vlefte lek
a1	Mbareshtim pyjesh në pyje të lartë (Trungishtet klasa e I deri e III e moshës)	Ha	550.7		
a2	Mbareshtim pyjesh në pyje të lartë (Trungishtet klasa e IV e lart e moshës)	Ha	104.3		
a3	Mbareshtim pyje të ulët (cungishtet)	Ha	170.7		
a4	Shkurre	Ha	659.41		
a5	Toke me bimësi pyjore,djerr,inproduktive	Ha	740.1		
a6	Kullota dhe livadhe.	Ha	334.7		
Siperfaqja totale e ekonomise sipas VKM 684 date 02.09.2020			2559.9		
Shuma pa TVSH					
TVSH 20 %					
Vlera e projektit me TVSH					
Totali lek:					

3. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PMPK

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave në zyrë.

Keto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për subjektin që do të përgatisin Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për Bashkinë Librazhd, bazuar në Udhëzuesin e lartë përmendur.

3.1 DETYRAT QË NDIQEN PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Detyrat që duhet të zbatohet subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janë:

- ✓ Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore.
- ✓ Përshkrimi i përgjithshëm në terren i parcelave e n/parcelaveve, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse.
- ✓ Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:
 - Trungishte
 - Cungishte
 - Shkurre

- ✓ Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës.
- ✓ Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta).
- ✓ Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve.
- ✓ Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë.
- ✓ Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës.
- ✓ Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës.
- ✓ Hartografimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë:
 - Ekonominë pyjore, ndarjen e parcelave e të n/parcelave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes
 - Përdorimin e territorit të zonës.
 - Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve.
 - Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë.
- ✓ Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.
- ✓ Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësi.
- ✓ Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore.
- ✓ Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit.
- ✓ Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë.
- ✓ Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
- ✓ Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara.
- ✓ Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat etj).
- ✓ Recensime të draft-planit të përgatitur.
- ✓ Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

3.2 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Neshtë-Prevall (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifikë të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, do të jenë:

- ✓ Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat.
- ✓ Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.

- ✓ Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunktionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- ✓ Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.
- ✓ Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.
- ✓ Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungsishteve me funksion prodhues.
- ✓ Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.
- ✓ Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.
- ✓ Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.
- ✓ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat përdoruesve.
- ✓ Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e tij në SISP.

3.3. QËLLIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm".

Ky plan hartohet për ekonomitë pyjore që janë pjesë e Bashkisë Neshtë-Prevall dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme. Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndëveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit të SISP dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

3.4. FAZAT QË NDIQEN PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE

Sipas Udhezuesit, procesi i hartimit të PMPK duhet të ndjekë këto faza:

- a) Puna përgatitore
- b) Puna në terren
- c) Puna në zyrë

Puna përgatitore:

- ✓ Grumbullimi i të dhënave ekzistuese dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PMPK
- ✓ Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela
- ✓ Futja në SISP e planit të ri të mbarështimit dhe menaxhimi i procesit të punës
- ✓ Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesmarrjes së aktoreve

Puna në terren dhe përshkrimi parcelar:

- ✓ Vizitat në terren
- ✓ Përshkrimi parcelar
 - *Struktura e përshkrimit parcelar*
 - *Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP.*
- ✓ Hartimi i hartës paraprake dhe ndërtimi i rrjetit të sipërfaqeve provë
- ✓ Mjetet për punën e terrenit
- ✓ Planifikimi inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të sipërfaqeve provë
- ✓ Metoda e inventarizimit dhe kampionimi për matjet e kullotave
- ✓ Produktet pyjore jodrusore (bimët aromatiko-mjekësore, frutat pyjore, lulet, farat etj.)
- ✓ Futja e të dhënave dhe kontrolli
- ✓ Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP

Puna në zyrë/raportimi:

Proçesi për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të respektojë standartet në mënyrë që të përftohen produkte finale homogjene (raporti, të dhënat, hartat etj) me qëllim përpunimin e të dhënave, transferimin e tyre në SISP dhe një koherencë me IKP. Pjesët e shkruara të raportit, tabelat dhe hartat duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e dhëna në Udhëzuesin për Planet e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019.

3.5 PËRMBAJTJA E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE

1. HYRJE

- 1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK)
- 1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë
- 1.3. Metodologjia e Punës
- 1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË

- 2.1. Informacioni i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore
- 2.2. Pronësia, administrimi, organizimi
- 2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative
- 2.4. Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore
- 2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore
- 2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike

- 2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore
- 2.8. Gjuetia dhe peshkimi
- 2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike
- 2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 3.1. Mbarështrimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave
 - 3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual & propozimet)
 - 3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
 - 3.1.3. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela

4. KUSHTET STACIONALE

- 4.1. Klima
- 4.2. Topografia dhe morfologjia
- 4.3. Gjeologjia
- 4.4. Tokat
- 4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë
- 4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhiet ujore
- 4.7. Rrëshqitjet

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

- 5.1. Brezat bioklimatike
- 5.2. Pyjet dhe kullotat
- 5.3. Tipet e pyjeve
- 5.4. Tipet e kullotave
- 5.5. Tipet potenciale të vegjetacionit
- 5.6 Biodiversiteti
- 5.7. Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)
- 5.8. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin
- 5.9. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 6.1. Analiza e të dhënave për Pyjet
 - 6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve
 - 6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes
 - 6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit
- Paraqitja në formë tabelare e të dhënave për secilën formë qeverisje në lidhje me:
- sipërfaqen totale kundrejt klasës së moshës
 - volumin për hektar kundrejt klasës së moshës
 - sipërfaqen e specieve në raport me klasat e moshës
 - volumi i specieve kundrejt klasave të moshës
 - sipërfaqen totale për klasa prodhimi
 - volumin total për klasa prodhimi
 - sipërfaqja sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit
 - volumin sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit
- 6.2. Analiza e të dhënave të kullotave
 - 6.2.1. Gjëndja e kullotave
 - 6.2.2 Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre

- 6.2.3. Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike
- 6.2.4. Mbritshmëria
- 6.2.5 Grumbullimi i të dhenave për zonat e djegura në kullota (10 vitet e fundit).

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KKULLOTAVE

7.1 Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve

- 7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit
- 7.1.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë
- 7.1.3. Struktura Vertikale
- 7.1.5. Cilësia e materialit drusor
- 7.1.6. Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomases
- 7.1.7. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit

7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare

- 7.2.1. Drurët e tharë
- 7.2.2. Dëmtimet e tjera

7.3. Prerjet e paligjshme

- 7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit
- 7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

7.4 Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave

- 7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave
- 7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha
- 7.4.3. Llojet e bagëtive
- 7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave
- 7.4.5. Infrastruktura aktuale
- 7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore.

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë
- 8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave
- 8.3. Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie
- 8.4. Objektivat kryesore të PMPK
- 8.5. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM
- 8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështimit
- 8.5.2. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve
- 8.5.3. Objektivat specifik silvikulturale
- 8.5.4. Objektivat specifik për kullotat
- 8.5.5. Objektivat specifik mbi biodiversitetin
- 8.5.6. Objektivat specifik mbi gjëndjen shëndetsore
- 8.5.7. Objektivat specifik mbi faunën
- 8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues
- 8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës
- 8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni
- 8.5.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues.

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PK.

- 9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit
- 9.2. Prerja vjetore silvikulturore
- 9.3. Planifikimi vjetor i masave
 - 9.3.1. Masat në Pyje
 - 9.3.2. Masat në kullota
 - 9.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike
- 9.4. Masat afat-gjata
 - 9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte
 - 9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte
 - 9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre
 - 9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi
 - 9.4.5. Masat në kullota
 - 9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore
 - 9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

10. VLERËSIMI EKONOMIK

- 10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota
- 10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve
- 10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve
- 10.4 Analiza kosto-përfitim

3.6. PËRGATITJA E HARTAVE

Me rëndësinë që kanë hartat tematike në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

- ✓ Tematika e hartave në përshtatje me kushtet e reja të territorit
- ✓ Elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat
- ✓ Dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS.

Hartat që do të përgatiten nga kontraktori në kuadër të planit të mbarështimit duhet të jenë të dixhitalizuara, të gjeoreferuara, me të gjitha elementët identifikues (kuota, rrjeti rrugor, rrjeti hidrik, emërtesat e vendeve, kufijtë e zonave të mbrojtura, izoipset kryesore etj) në shkallën 1:10 000 dhe 1:25 000. Hartat duhet të prodhohen nëpërmjet platformes së informacionit SISP.

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Plani i Mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 4 kopje të printuara dhe 4 kopje në format elektronik (CD). Cilësia e materialeve që do të përdoren për printimin e planit të mbarështimit dhe hartave duhet të jete e katerorisë më të mirë të ofruar në treg. Hartat do të vishen me material plastik rezistues ndaj ujit.

Hartat duhet të realizohen në sistemin GIS dhe ato që do të përgatiten janë:

1. Harta e Ekonomisë Pyjore
2. Harta e Funksioneve
3. Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave
4. Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe sipërfqeve të degraduara
5. Harta e ndërhyrjeve

4. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këto ekonomi pyjore parashikohet një afat kohor **1 vit me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar.**

Nr.	Aktiviteti	Muaji												
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Punime përgatitore													
2	Punimet e terrenit													
3	Punimet e zyrës													
4	Përgatitja Draft Planit													
5	Dorëzimi i Draft Planit të Mbarështimit													
6	Raportimi përfundimtar													
7	Diskutim me aktorët e fushës dhe mbrojtja e Draft Planit													
8	Dorëzimi i Planit të ri të Mbarështimit													
9	Paraqitja/Miratimi ne Keshillin e Bashkise													
10	Miratimi prane MTM/AKM													

Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.